



LAJMËRIM

Mbi zhvillimin e sesionit të provimeve të dimrit në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave

Pas diskutimeve në mbledhjen e Rektoratit mbi vendimet e Komitetit të Ekspertëve dhe sugjerimet e MASR në lidhje me sesionin e provimeve, ju njoftojmë se:

1. Sesioni i provimeve të dimrit në FGJM do të zhvillohet përgjithësisht në auditor.
2. Sesionit të planifikuar në strukturën vjetore të procesit mësimor 15. 02 – 12. 03. 2021 ju shtuan edhe dy javë, pra tashmë sesioni i provimeve do të shtrihet deri në ditën e Premte, **dt. 26 Mars 2021**.
3. Orari i provimeve për sesionin e dimrit për nivelin e parë të studimeve (Bachelor) dhe për nivelin e dytë (Master) do të publikohet në faqet zyrtare të FGJM (www.fgjm.edu.al, www.dibmin-fgjm.org, në faqen e Facebook dhe sipas mundësive, në klasat online në platformën Google Classroom të FGJM). Ky orar do të jetë subjekt i ndryshimeve kështu që ju këshillojmë të jeni të përditësuar me njoftimet ditë pas dite.
4. Për lëndët që kanë detyrime të pashlyera apo që kërkojnë seanca laboratorike të veçanta, datat e provimeve do të caktohen në dy javët e fundit të sesionit të provimeve, për t'ju dhënë mundësi studentëve që të marrin pjesë në laboratorë në auditor, duke zbatuar rreptësisht rregullat AntiCovid në fuqi.
5. Sipas rekomandimit të MASR, mungesat në mësimin online nuk do të jenë kriter pengues për hyrjen në provim, duke marrë parasysh vështirësitë e situatës ku ndodhemi dhe vështirësitë në infrastrukturën teknologjike për studentët.
6. Për studentët që e kanë të pamundur pjesëmarrjen në provime këtë sesion për arsye objektive (pamundësi fizike, karantinim, sëmundje etj) dhe që mund të vërtetojnë pamundësinë e tyre, do të ketë një sesion të ndërmjetëm rreth muajt Maj.
7. Kohëzgjatja e provimit, nëse është mundësia, do të jetë 60 minuta, duke patur parasysh se kjo është koha maksimale e rekomanduar për qëndrimin në grup në ambiente të mbyllura.
8. Nëse në një sallë ka dy provime të njëpasnjëshme, ata do të ndahen nga një kohë jo më pak se 30 minuta, kohë e cila do të shërbejë për të ajrosur sallën dhe për të bërë mundësisht një desinfektim me solucione me bazë alkooli të bankave.
9. Numri i studentëve në sallë do të jetë në varësi të sipërfaqes së sallës, duke respektuar me rigozitet të gjitha udhëzimet Anticovid si në lidhje me distancën ashtu edhe me mbajtjen e maskave (në mënyrë efektive) gjatë gjithë periudhës së provimit.



10. Studentët duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me pedagogët e lëndëve nëpërmjet platformës Google Classroom të FGJM për zhvillimin e mësimit online dhe nëpërmjet komunikimeve me rrugë të tjera elektronike, në mënyrë që të marrin informacion të përditësuar në lidhje me shlyerjen e detyrimeve për lëndët para provimeve, konsultime apo udhëzime të tjera me vlerë gjatë sesionit të provimeve.

Në faqet elektronike të FGJM dhe në klasat online të platformës Google Classroom të FGJM (nga pedagogët e lëndëve) do të publikohen të gjitha njoftimet dhe udhëzimet më të fundit për ecurinë e procesit të provimeve gjatë sesionit të dimrit në FGJM.

Besojmë dhe shpresojmë që me angazhimin e të gjithëve, pavarësisht kushteve jo normale, të mund të zhvillojmë një sesion provimesh të realizuar plotësisht dhe të sigurtë.

Ju urojmë suksese!

Zv. Dekani për mësimin

Dr. Altin KARRIQI